



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.23/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Selvije Kurtit, kandidate për asamblenë komunale në Mitrovicë nga iniciativa qytetare Te pavarurit e Mitrovicës, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të për shkak se nuk është zëvendësuar dhe nuk është emëruar për anëtare të Kuvendit Komunal të Mitrovicës, në seancën e panelit të mbajtur me 13.03.2017, mori këtë:

V E N D I M

KONSIDEROHET si e tërhequr ankesa e Selvije Kurti Anr. 23/2017 e paraqitur më dt. 09.03.2017.

A r s y e t i m

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, me datë 09.03.2017 ka pranuar një ankesë nga Selvije Kurti kandidate për anëtare të Kuvendit Komunal të Mitrovicës nga Iniciativa Qytetare "Të pavarurit e Mitrovicës", e paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, me të cilën pretendon se pas dorëheqjes të bartësit të listës të iniciativës qytetare në fjalë nga funksioni i anëtarit të Kuvendit Komunal të Komunës së Mitrovicës, KQZ ka certifikuar kandidatin me më pak vota se parashtruesja e ankesës, dhe me arsyetimin se zëvendësimet në Kuvendin Komunal duhet të bëhen me personat e gjinisë së njëjtë. Parashtruesja e apelit kërkon nga PZAP, që ta anulojë vendimin e KQZ-së pasi që siç thekson ajo, zbatimi i legjislacionit për kuotën gjinore ka të bëjë me nevojën për diskriminim pozitiv të grave dhe jo për diskriminim të burrave.

PZAP-i, në kuptim të nenit 6 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me datën 09.03.2017 kërkoi nga parashtruesja e ankesës që deri me datën 10.03.2017 ta plotësoj ankesën Anr. 23/2017 gjegjësisht që ta specifikoj saktësisht se ndaj cilit vendim të KQZ ka ushtruar ankesë, si dhe datën dhe kohën kur është marrë ky vendim, pasi që një specifikim i tillë nuk është potencuar në ankesë. Me të

njëjtin njoftim PZAP-i, i ka bërë të ditur parashtrueses së ankesës se do të konsiderohet e tërhequr ankesa po që se nuk i kthehet PZAP-it deri më datën 10.03.2017 në ora 16:00.

Përkundër kërkesës së bërë nga PZAP-i, parashtruesja e ankesës nuk ofroi përgjigjen e kërkuar lidhur me plotësimin e ankesës në fjalë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj shkresat e lëndës mori vendim që **ankesa të konsiderohet si e tërhequr** për këto arsye:

PZAP-i konstaton se përkundër kërkesë së bërë ndaj parashtruesës së ankesës lidhur me plotësimin e ankesës ashtu siç edhe parashihet me dispozitat e nenit 6.3 dhe 5.7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, parashtruesja nuk ka e ka bërë plotësimin e ankesës në fjalë dhe as që nuk e ka dorëzuar fare të njëjtën në PZAP. Bazuar në nenin 6.3 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ankesa do të konsiderohet si e tërhequr po që se nuk i kthehet PZAP-it brenda afatit të caktuar, e në qoftë se i kthehet e pa korrigjuar, gjegjësisht pa u plotësuar brenda afatit të përcaktuar nga PZAP-i, e njëjta do të hidhet si e pa rregullt.


Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë, bazuar në nenin 6 par.3 dhe nenit 5.7 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it lidhur me nenin 118 par. 1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr. 23/2017 më datën 13.03.2017

Kryesuesi i Panelit,
Dr.sc. Rafet Haxhaj

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24)orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës.

The image shows a circular official stamp of the Panel of Arbitration for Complaints and Petitions (PZAP) in Pristina. The stamp contains the text 'Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia' around the perimeter and 'PZAP' in the center. Below the stamp, there is a handwritten signature in blue ink.